

## **Procedurat e vizave**

### **Viza për vizita të shkurtra në shtete të ndryshme**

Kërkesa për këtë lloj vize duhet t'i drejtohet misionit diplomatik të shtetit që është destinacioni juaj kryesor i udhëtimit ose misionit diplomatik të shtetit që përfaqëson atë shtet, sipas rastit.

Tarifa e kërkesës për vizë paguhet në Lek të llogaritur kundrejt normës përkatëse të këmbimit [1]. Nëse kërkesa për vizë refuzohet, tarifa nuk kthehet.

Duhet të kihet parasysh se informacioni në këtë dokument është i përgjithshëm dhe seksioni i vizave në Përfaqësi të ndryshme ka të drejtën të kërkojë dokumente të tjera shtesë në mbështetje të aplikimit.

### **Dokumentet që duhet të paraqiten personalisht për kërkesën e vizës:**

- Një pasaportë e vlefshme dhe fotokopje e faqeve të pasaportës që përmbajnë informacion. Pasaporta duhet të jetë e vlefshme për të paktën tre muaj pas skadimit të vizës;
- Një formular i plotësuar i kërkesës i nënshkruar rregullisht nga kërkuesi. Formularë bosh të kërkesës mund të merren falas në çdo Ambasadë apo në faqen e saj të internetit;
- Dy fotografi të madhësisë së fotografisë së pasaportës të marra në një sfond të bardhë;
- Certifikata [3] të lindjes dhe familjare të kërkuesit ose një kopje të kartës biometrike të identitetit;
- Për fëmijët e pashoqëruar nën 18 vjeç: një deklaratë e noteruar nga prindi që nuk udhëton [4] ;
- Për studentët: një dokument miratues nga institucioni shkollor i shtetit ku do të shkohet.;
- Sigurimi i udhëtimit/shëndetit për raste urgjence mjekësore dhe kthim në Atdhe;

**Në varësi të arsyeve të udhëtimit, duhet të paraqiten edhe këto dokumente:**

### **Vizë vizitori**

- Garanci mbështetjeje nga personi pritës (dhe një fotokopje) [6] ose prova që ka mjete të mjaftueshme financiare që ka kërkuesi (d.m.th, deklaratimet bankës së tij/saj që tregojnë një periudhë operimi të paktën tre muaj, certifikata pensioni ose të sigurimeve shoqërore, kontratë punësimi)
- Nëse kërkuesi dhe sponsori / personi pritës kanë lidhje familjare ose gjaku, kërkuesi duhet të paraqesë dokumentet që provojnë marrëdhënien (p.sh, certifikata lindjeje ose martese);
- Letër punësimi ose dokumente regjistrimi biznesi nëse kërkuesi ka biznesin e tij / saj – d.m.th, vendim gjyqësor për përfundimin e licencës së biznesit, licencë biznesi dhe NIPT-in e shoqërisë;
- Rezervimin e udhëtimit (fluturim ose autobus, nuk është e nevojshme të paraqitet bileta e paguar)

#### **Vizë turisti**

- Provë të mjeteve të mjaftueshme financiare – p.sh, deklaratimet bankës personale të kërkuesit që tregojnë një periudhë operimi të paktën tre muaj, letër punësimi, ose kontratë punësimi, certifikata të sigurimeve shoqërore, dokumente regjistrimi biznesi nëse kërkuesi ka biznesin e tij / saj – d.m.th, vendim gjyqësor për përfundimin e licencës së biznesit, licencë biznesi dhe NIPT-in e shoqërisë;
- Rezervimin e hotelit dhe udhëtimit ( nuk është e nevojshme të paraqitet bileta e paguar).

#### **Vizë biznesi**

- Letër kërkesë / ftesë me shkrim [8] nga shoqëria pritëse ose personi juridik, zyra, shteti ose autoriteti lokal dhe duhet të verifikohet ekzistenca e një biznesi në Qendrën Kombëtare Shqiptare të Regjistrimit. Ftesa duhet të lëshohet jo më shumë se 2 muaj para datës së kërkesës;
- OSE letër nga një shoqëri shqiptare, që përmban hollësitë tuaja personale, rolin tuaj në biznes dhe qëllimin dhe gjatësinë e udhëtimit (origjinale ose kopje). Letra duhet të lëshohet jo më vonë se 2 muaj para datës së kërkesës DHE letër ftesa nga shoqëria pritëse që konfirmon që ajo do të mbulojë shpenzimet financiare, ose prova

të mjeteve të mjaftueshme financiare (për shembull, deklarin të bankës personale dhe/ose një certifikatë nga punëdhënësi që konfirmon që ai do të mbulojë shpenzimet)

- Nëse ka një ortakëri biznesi me shoqërinë pritëse, prova që provojnë ekzistencën e saj (fatura, lista të porosive të produkteve, etj)
- Letër punësimi i kërkuesit [9]
- Dokumente të regjistrimit të biznesit të shoqërisë ku kërkuesi punon (vendim gjyqësor për përftimin e licencës së biznesit, licencën e biznesit dhe NIPT-in e shoqërisë)
- Prenotimin e hotelit dhe udhëtimit [10] ( nuk është e nevojshme të paraqitet bileta e paguar).

#### **Vizë për të marrë pjesë në aktivitete kulturore dhe shkencore**

- Një kërkesë me shkrim / letër ftesë nga institucioni pritës për të marrë pjesë në Aktivitet;
- Një letër ftesë nga institucioni pritës që konfirmon që ai do të mbulojë shpenzimet financiare, ose prova të mjeteve të mjaftueshme financiare (për shembull një deklarin të bankës personale);
- Letër punësimi ose arsimit dhe dokumente të regjistrimit të biznesit (licencë biznesi);
- Rezervimin e hotelit dhe udhëtimit ( nuk është e nevojshme të paraqitet bileta e paguar).

#### **Viza për shoferë që bëjnë shërbime të transportit ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve [11]**

- Një kërkesë me shkrim nga shoqata kombëtare e transportuesve të Shqipërisë që sigurojnë transport rrugor ndërkombëtar, duke deklaruar qëllimin, kohëzgjatjen dhe shpeshtësinë e udhëtimeve;
- Prova të mjeteve të mjaftueshme financiare (për shembull, një deklarin të bankës personale dhe/ose letër nga punëdhënësi që konfirmon që ai do të mbulojë shpenzimet)

- letër punësimi ose dokumente të regjistrimit të biznesit (licencë biznesi);
- Fotokopje të lejes së drejtimit të vlefshme ndërkombëtare dhe kombëtare;
- Dokumente të regjistrimit të automjetit.